



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02Nr.060103-8788 dt. 22/02/2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **29.02.2024** (e Enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Znj. Kosovare Halilaj Karaxha, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Drenas, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës" duke zëvendësuar znj. Albulena Saliuku e cila lirohet prej detyrës të anëtares së Kuvendit Komunal.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të kuvendit Komunal i mbajtur më dt. 29.01.2024.
3. Propozim vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 02-353/01-5031 dt.29.01.2024 për caktimin e lokacionit për realizimin e projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.
4. Propozim vendim për subvencionimin e nënave lehona.
5. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtareve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A
6. Të ndryshme.

Drenas, 22.02.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

06-02-2024

Prishtinë / Priština

Nr./Br. CMIA/08-2024



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, me votim në procedurën qarkulluese më datë 06.02.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Kosovare Halilaj Karaxha**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Gillogovc, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Albulena Saliuku.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Kosovare Halilaj Karaxha dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 02.02.2024, Nr.09/1/102/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Albulena Saliuku, për arsye të emërimit Drejtoresh në Drejtorin për Buxhet dhe Financa.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është znj.Kosovare Halilaj Karaxha.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 06.02.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-8786 dt. 22/10/2024

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: 29.01.2024
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD).

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-s zyra e informimit, qytetar.**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i dt. 27.12.2023
2. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023.
3. Propozim Vendim për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale.
4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndertimin e objekteve të qerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.
5. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
6. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë.
7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit në zonën kadastrale Kishnarekë.
8. Propozim Vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 Shtrubullojë.
9. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullojë

10. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2023.
11. Raporti i punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe plani i implementimit të rekomandimeve.
12. Raporti i performancës komunale për vitin 2022.
13. Raporti i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020.
14. Plan i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
15. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtareve të komisionit komunal aksionar për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A.
16. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. **29.01.2024**, ku për diskutim ishin 16 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Beqir Kiqina: Unë jam parimisht pro këtij rendi të ditës mirëpo kërkoj që ta mbajmë një takim me përfaqësuesit e partive politike për ta hartuar agjendën dhe planin e punës për Kuvendin Komunal.

Egzona Tërdevci: pasi përshëndeti të pranishmit, theksoj se i kam dërguar dy email-a për materiale shtesë lidhur me këtë seancë, njëra ka qenë për raportin e auditimit të brendshëm të Komunës së Drenasit e tjetra ka qenë për këto me prona, po më shqetëson fakti se materialet po na vijnë direkt vetëm në seancë, kështu që ne s'kemi kohë me analizu dhe nuk ka shumë kuptim me i diskutu e sa i përket përgjigjes për raport të brendshëm të auditimit, përderisa një diskutimi i një raporti të tillë është pjesë e treguesve të raportit të performancës komunale nuk e shoh të arsyeshme as të drejtë përgjigjen e z.Kamer Ramaj, nga Zyra e Auditimit të Brendshëm, për shkak se nuk kemi çka të diskutojmë një raport siç na ka ardh në e-mail-at tona pasi që nuk ka asgjë përmbajtësore, nuk mundemi ne që t'i diskutojmë rekomandimet, kur nuk i dimë as llojet e auditimit që janë bërë e as nuk i dimë rekomandimet për secilin auditim, veç e veç, në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje, propozoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, për arsye se nuk mund ta diskutojmë një pikë të tillë pa i pas materialet e nevojshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: auditori i brendshëm bën raport veç për kryetarin e komunës, është këshilltari i kryetarit të komunës, edhe raport përgjigjen që e ka dhanë është shumë e saktë edhe brenda ligjit. Auditori do të jetë këtu kur të vijë pika e rendit të ditës me diskutu. Unë kam prurë raportin dy herë në vit, raportin e punës së kryetarit ku përfshihet edhe raporti i auditorit. Pra, ai është në zyrën tem punonjës dhe hyjmë kuadër të raportit. Pra ju ftoj me votu këtë pikë të rendit të ditës për shkak se në grant të performancës nëse nuk e votoni këtë pikë të rendit të ditës për diskutim, ia humbni tri pikë komunës në grantin e performancës.

Egzona Tërdevci: Kryesues, unë veç po të ftoj me e mbajte rendin e diskutimit edhe kur unë nuk diskutoj asnjëherë në baza personale, po diskutoj për problemet që më interesojnë edhe mu si përfaqësuese e qytetarëve, po edhe qytetarëve të cilët i përfaqësoj, ju lutem, në të njëjtën konsideratë me pas edhe ekzekutive edhe jo në raport me mua, sepse asnjëherë

diskutimi prej meje nuk ngritët mbi baza personale, po ngritët mbi bazat e shqyrtimit të problemeve dhe ankesave që unë i marr prej qytetarëve si asamblistë, përdërisa po tregoj respekt e prës veç njëjtën prej juve.

Kryesuesi i Kuvendit Milaim Hajdari: ne veç e kemi një plan punën, edhe vazhdojmë tutje, ne e bëjmë një takim brenda këtij muaji me shefat e grupeve kuvendare dhe nëse ka diçka e inkorporojmë në plan pune.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 27 anëtar, “Për” votuan 27 anëtar, kundër nuk pati, 4 abstenim, u miratua rendi i ditës me pikat e lartcekura.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.12.2023.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, “Për” votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti Financiar Janar-Dhjetor 2023.**

Nuk pati diskutime vazhduan me piken e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për ndarjen dhe bashkimin e parcelave kadastrale.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, “Për” votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objekteve të çerdheve në Tërstenik dhe Nekoc.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, “Për” votuan 31 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovc: pika e pestë është sjellë për propozim në Kuvend me arsyetimin që komuna jonë ka nevojë me i zhvillu komunën edhe pronat e veta, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik i ka paraqitë një numër ose një listë Kuvendit që sot për miratim paraprak të vendimit, dhënies, pronave të paluajtshme të komunës, Drenasit, në shfrytëzim afatgjatë të personave fizikë e juridikë me qëllim të hapjes ose krijimit të vendeve të punës dhe të hyrave për komunën tonë.

Unë e kam obligim ligjor, sikurse e kam obligim me dërgua listën paraprake para vitit të ri ose me e shpall listën në faqe të Kuvendit e kam obligim me e sjell edhe para juve një listë, sillen drejtoria përkatëse e ka mendu që mund me qitë në thirrje publike për me i ftu bizneset me investu në pronat të cilat i ka Komuna e Drenasit me qëllim të rritjes vendeve të punës e të zhvillimit në komunë.

Pra, ju lus publikisht ta votoni këtë listë paraprake sepse është në interes të zhvillimit të komunës, e keni pastaj dhe pas shpalljes ose thirrjes publike për aplikim të bizneseve, e keni edhe një herë miratimin veç e veç të çdo prone, pra ju thërras ta votoni, t'i hapni rrugë zhvillimit ekonomik, punësimit dhe të hyrave për komunën në që do shfrytëzohen të mirë qytetarë të komunës tonë.

Arbër Halilaj: LIGJI NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ka për qëllim t'i mundësoj komunave shfrytëzimin efektiv të pronës së paluajtshme me qëllimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, rritjes së vlerës së pronës së paluajtshme të komunës dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve të Drenasit për punësim dhe mirëqenie për të gjithë.

Ne si opozitë e kemi dëshmuar se jemi pro zhvillimit ekonomik të komunës, rritjes së kapaciteteve prodhuese, gjenerimit të vendeve të punës si interes i përgjithshëm etj, për çka edhe duhet të jepet prona komunale, siç është rasti kur në Tetor 2023 votuam pro dhënies së pronave komunale kompanisë prodhuese në shpezëtari "Frida's Farm" dhe kompanisë për energjinë e ripërtëritshme solare TDI Balkans.

Sot, kur kemi një listë të gjatë të pronave me propozimin për miratimin paraprak të Vendimit për dhënie të tyre në shfrytëzim në afat maksimal prej 99 vitesh, ne nuk kemi së pari një Raport të detajuar për statusin e pronave të dhëna në shfrytëzim më herët, kryerjen apo moskryerjen e obligimeve kontraktuale dhe pagesave nga ana e investitorëve ndaj Komunës, kush janë shfrytëzuesit dhe a i kanë zbatuar pikërisht projektet e prezantuara si investitorë me rastin e aplikimit, sa është numri i të punësuarve në këto prona-biznese, përfitime këto me interes të përgjithshëm nga dhënia në shfrytëzim e pronave. Te pika 9 në fakt kemi një raportim sipërfaqësor tekstual për 5 operator ekonomik që kanë marrë prona komunale të dhëna në shfrytëzim në v.2020 dhe kaq.

Përveç publikimit të këtyre përfituesve individual apo biznes-or, do të duhej që para dhënies së pronave tjera në shfrytëzim, Asambleja dhe opinioni publik të njoftohet se a kemi prona të uzurpuara komunale, cilat janë saktësisht ato dhe çfarë ka ndërmarrë komuna për t'i kthyer ato prona në shfrytëzim të vetin. Komuna do të duhej të publikojë me emër e mbiemër listën e uzurpatorëve të pronës komunale, si veprim në kuadër të qeverisjes transparente dhe si llogaridhënie para qytetarëve.

Më e rëndësishmja, lista nuk përmban ndonjë arsyetim përmbajtjesor të interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Drenasit, që mund të sjellë dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim. Ne si asamble duhet të analizojmë mirë se çka kemi dhënë në shfrytëzim deri tani nga pronat, kush janë përfituesit, si ka rezultuar kjo në zhvillimin ekonomik të Drenasit dhe mirëqenien e përgjithshme, zbutjen e papunësisë etj. që me votën tonë mos t'i hapim rrugë dhënies së pronave komunale në shfrytëzim për interesa klanore dhe jo në të mirë të qytetarëve, punësimit të tyre apo zhvillimit ekonomik të komunës.

Unë nuk i shoh si interes publik dhe si bazë të zhvillimit ekonomik të Drenasit ndërtimet e larta, për çfarë destinohen shumica e pronave komunale në qytetin e Drenasit, e aq më pak si përfitim me interes të përgjithshëm të qytetarëve.

Kësisoj, bazuar në këto theksime të më sipërme dhe nevojën për informim të gjithanshëm të Asamblesë për pronat e dhëna deri tani, si dhe arsyetimin specifik se cili është destinimi që siguron zhvillim ekonomik, punësim dhe mirëqenie të qytetarëve të Drenasit si një interes i përgjithshëm përmes propozimit të sotëm, unë sugjeroj që paraprakisht të shtyhet kjo pikë për seancën e radhës, përderisa në ndërkohë të informohemi me detajet që i potencova më sipër.

Egzona Tërdevci: para se të filloj me fjalën lidhur me këtë pikë, unë kam një propozim lidhur me këtë pikë, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit Komunal të Drenasit, përkatësisht pikës 16.4 apo nën paragrafi C, ne kemi mundësi me propozim të kryesuesit apo të ndonjë grupi parlamentar të bëjmë votim të regjistruar. Në emër të Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje propozoj që për këtë pikë të bëhet votim i regjistruar.

Pra, kjo është përkitazi me Rregulloren e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe kryesues ju lus që ta hidhni në votim këtë propozim timin para votimit të kësaj pike.

Si grup i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje parimisht jemi kundër dhënies së pronave në shfrytëzim për 99 vite e arsyet për ta kundërshtuar edhe më shumë këtë vendim, rriten me faktin se nuk ka asnjë analizë të mirëfilltë në atë se si ndikon në aspektin ekonomik dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave dhe cili është përfitimi që e ka komuna jonë nga ky veprim. Fakti që sot para nesh kemi një propozim për t'i dhënë në shfrytëzim shtatëdhjetë prona për nëntëdhjetë e nëntë vite, tregon shumë për atë se sa e vlerëson z.Lladrovci pronën publike e si po provon ta keqpërdorë atë në kurriz të qytetarëve e jetës publike të Drenasit?

Është Paradoks në vete fakti që pak më parë ne i ndamë dy parcela për dy çerdhe që janë investim nga Qeveria Kurti, pra çerdhja në Tërsenik dhe në Nekoc më vonë do ta kemi edhe një propozim për të ndarë një parcelë për stacion sizmik, madje edhe një propozim tjetër për shkollën apo paralelin e shkollës "Rasim Kiçina" e në të njëjtën kohë, paralel me këtë, ne duam të japim një shfrytëzim 99 prona për persona privat, pa një analizë se çfarë përfitimi do t'i sjellim

këto investime qytetit tonë.

Jemi dëshmitarë të asaj se dhënia në shfrytëzim e pronave për 99 vite për persona fizikë e juridik as nuk i ka sjellë përfitimet e mëdha komunës, siç është pretenduar shpesh e as nuk kanë përfituar qytetarët nga to.

Të vetmit përfitues të këtyre Investimeve janë ato biznese që duke mos i realizuar investimet sipas kriterëve e duke ju shmangur premtimeve për punësimin rekord dhe të punëtorëve, kanë trashur edhe më shumë fitimet e tyre.

Për ne Vetëvendosjen shqetësuese është secila pronë nga lista e shtatëdhjetë pronave që do të jepet një shfrytëzim për 99 vite, gjithëherë duke mos pasur një analizë të mirëfilltë, e cila e paraqet përfitimin që do të ketë komuna nga dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave, por në mesin e këtyre pronave ka prona që do të duhej të mbeteshin publike gjithnjë e ka prona që tashmë po shfrytëzohen, por ky vendim po merret sa për sy e faqe.

Po filloj me parcelën 1032-2, apo objektin e vjetër të komunës së Drenasit, ky objekt me ngulm ishte provuar të ipen nga ju në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite, në fund të vitit,

2022, e për të siguruar votat që t'ua kaloni këtë pronë në pronësi disa të njohurve tuaj, z.Lladrovci, e duke e kamufluar me arsyetimin e zhvillimit të qytetit, Ju kishit lënë nder pa trokitur e pazar pa provu për t'i siguru këto vota.

Ju shpeshherë na keni thënë që e ktheni edhe të mirën, edhe të keqen, por ama favoret e fushatave ju lutem ktheni me paratë e juaja e jo me paranë publike të qytetarëve të Drenasit. Si qytetarë e këtij vendi, nuk mundem me kuptu se cili është interesi publik e ekonomik i komunës që objekti i vjetër i komunës sonë të shfrytëzohet për ndërtim të lartë.

Ky objekt, ku gjendet salla e vetme e kulturës në qytetin tonë, duhet të mbetet objekt publik. Veç sallës së Kulturës, me një rinovim në këtë objekt do të mund të krijohej hapësira që mund t'i duhen komunës, siç janë zyra për KVL e për organizata tjera që angazhohen në interes publik por assesi nuk e kuptoj se si i shërben interesit publik ndërtimi i një objekti të lartë në atë parcelë.

Po e ripërsërisim që nga viti 2022 në këtë objekt bën një punë të jashtëzakonshme edhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave dhe është mëkat që një organizatë e tillë të mbetet pa objekt për ta ushtruar veprimtarinë e tyre. Dhe shpesh në këtë Kuvend është përmendë nga ju zotëri Lladrovci që ato gra do të vendosen në një objekt dinjitoz, por kjo nuk ka ndodhë ende.

Dy pronat tjera në vijim janë në Gllabor, bëhet fjalë për parcelën 12-0, e cila siç mund të shihet edhe nga gjeoportali, por edhe nga ajo që e di nga terreni, veç është në shfrytëzim. E njëjta edhe parcela 13-0.

Afër parcelës trembëdhjetë pikë zero po ndërtohet një restorant.

Pra, afër pishave.

Ndërtuesin sigurisht e njihni, e njoh edhe unë.

Në atë parcelë tashmë janë vendosur tuba të shumta dheu për t'u rrafshuar për t'u shfrytëzuar për parking.

Nuk do pra shumë mend për ta kuptuar se për kë është destinuar ajo. Një parcelë tjetër, për të cilën kemi diskutuar shumë në këtë Kuvend, është parcela shtatëqind e katërdhjetë e tre thye për tridhjetë. Parcelë kjo është pronësi në të cilën e kemi kundërshtuar në prill të vitit dy mijë e njëzet e dy, e tani kur po e shohim se kjo parcelë planifikohet për ndërtim të lartë, e kuptojmë edhe më mirë mospërkrahjen tuaj ndaj qytetarëve të Drenasit që kishim prona në atë parcelë.

Në këtë listë është edhe parcela shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë vizë dy, ku është çerdhja e vetme publike në Drenas.

Edhe kjo është destinu për ndërtim të lartë.

Çka me fol tjetër në këtë absurditet, kurë parcela ku gjendet çerdhja e vetme publike do të jepet për ndërtim të lartë.

Për parcelën 126-2, sa kemi ne informacione, tashmë ka një padi ndaj komunës për këtë çështje. Kjo pronë ka qenë në shfrytëzim më herët nga një përdorues që i shkëputu kontrata për të uzurpuar më pas kjo pjesë nga kompania që ka në shfrytëzim pronën, afër kësaj pronë. Madje, sipas informacioneve ka edhe një vendim gjyqi lidhur me këtë çështje, nga krejt kjo mund të konkludojmë që tashmë është e përcaktuar se kujt do t'i jepet edhe kjo parcelë.

Për fund, jo nga rëndësia, është parcela 726-17, ku ndodhet qendra e re tregtare.

Aq sa kemi ne informacione, këto prona janë blerë nga pronarët e tyre dhe aty janë bërë investime të shumta nga njerëz të qytetit tonë, të cilët ndoshta pasurinë e fundit e kanë investu në ato biznese duke mos pritë që ndonjëherë komuna do t'ua marrë tokën, duke parë të gjitha këto anomali e tendenca për të tjetërsuar pronën publike ne si Grup i Asamblesëve të

Lëvizjes Vetëvendosje assesi nuk e mbështetim një propozim të tillë dhe do të vazhdojmë të jemi çdoherë në mbrojtje të mirës së përgjithshme.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: sa prona janë në uzurpator në komunën tonë. E keni në faqe të komunës, janë mbi pesë mijë uzurpime në komunën tonë.

Mbi 2700, janë me ndërtime t'u përfshi objekte, shtëpi të cilat i kanë lëshua për biznes. Po flet për borxhe, cilën borxh e kanë pronat që i kemi lëshu në 2021, borxhe kanë pronat që i lëshu vite ma parë pa procedura të mirëfillta dhe ju e dini një objekt pronë, në shfrytëzim që u djeg para disa ditësh, ose para disa javësh, e ka borxhin ma të madh, mos më thoni pse ia keni shkëput kontratën njëanshëm, sepse ligji ma lejon ata që kanë borgj me ia shkëput kontratën njëanshëm atij që nuk i nuk e kryen njërën prej pikave të cilave ka marrëveshjen.

Ky Kuvend ka votu për planin zhvillimor të komunës, për hartën zonale dhe për planin urban, në qoftë se unë kam dalë jashtë këtyre tri vendimeve të Kuvendit edhe i kam propozu Prandaj, qytetari ia ka dhënë besimin shumicës këtu për me me vendos se çka me bo edhe t'u përfshi edhe pronat publike.

Krejt pronat, si i kemi dhënë, e kanë kry detyrën e vet me sukses.

I thërras asamblistët ta votojnë t'i hapin rrugë listës paraprake, pastaj me shku me thirrje publike.

Kjo është krejt në interes të qytetarëve të Komunës të Drenasit.

Egzona Tërdevci: Së pari, për propozimin për votim të regjistruar është propozim që është në Rregullore të Kuvendit. Z.Lladrovci, fole shumë, e përmende shumë gjana, veç për çka të pyeta nuk u përgjigje.

Ndoshta jemi katër, po pikërisht na katër kemi ndihmu që Komuna e Drenasit me mbetë ngarë për grant performansës, pasi na e kemi tejkalu inatin personal e politik që mund ta kemi dhe kemi ardhë këtu kemi votu pikërisht për shkak të interesave të qytetarëve të Drenasit.

Prandaj, nuk mundeni me na as me na etiketu si njerëz që po e pengojmë zhvillimin e as si njerëz që s'ia dojmë të mirën Drenasit se na në këtë Kuvend, po edhe jashtë Kuvendit se Para se me ardhë në Kuvend, secili e kemi një angazhim personal e publik, kemi dëshmu që na jemi në interes qytetarëve Drenasit, e këta kemi me vazhdu, me dëshmu ju pëlqeu, ose s'ju pëlqeu juve.

Bekim Lestrani: Unë dola këtu me kërkuar disa sqarime prej Drejtorisë për Zhvillim

Ekonomik meqenëse është listë e ngushtë, është listë për një vit, pse duhet të jenë shtatëdhjetë prona në këtë listë? A janë të menduara të gjitha si duhet.

Ka shumë prona që prekni shtëpi banimi, prekin familjet, prekin qytetarët tonë, pse?

Pse duhet prona të caktohen në fshatra, të futen me kaq ngulm?

Unë e kam një pyetje për drejtorinë: në fshatin Baicë e kam fut një pronë që prej familje ato që nuk është zone me interes, madje aty ka edhe familje dëshmori që banojnë mu brenda asaj zone që është futë, pse usht kjo unë mendoj që kjo listë duhet të shtyhet për një herë tjetër, të analizohet si duhet, Vota ime është kundër, me këtë formë si ka ardhë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: je i lirë me votu si te duash. Po folni edhe ti edhe një zonjë, këtu foli për nja dy prona në Gillobar që tha janë tu punu. Prej sot e kanë vendimin aty më mshel, sepse punojnë ilegalisht dhe si uzurpatorë.

Ligji vlen si për familjen e dëshmorëve, si të invalidit, njëjtë ligji është i njëjtë për të gjithë.

Nuk ka arsyetim ky.

Bekim Lestrani: Unë isha i qartë, nuk thashë pse është familje e dëshmorëve dikush a pse duhet ai me uzurpu, unë thashë pse në këtë vit pretendohet që të investohet mu aty ku janë ato familje edhe ato banojnë aty që pesëdhjetë vite edhe tash po të ishte një interes, duhet të na jep drejtoria për Zhvillim Ekonomik, çfarë është interesi?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Nuk kena asnjë pronë që e prek pronën private, shpalli në interes që ta keni qartë.
E dyta ne nuk mujna me shpallë pronë, të cilën e kemi në uzurpim, pa e zgjidhë si procedurë. I nderuar kryesues, pikën e pestë të rendit të ditës si kryetar komune e tërheq nga rendi i ditës.

Labinot Halilaj: të drejtën votës, sa kemi na të drejtë vote edhe qysh votojmë, është bindje jonë. Votimi ndryshe, qoftë për, qoftë kundër, qoftë abstenim, ka reflektu me veprimet tua që ti nuk e nuk je ai që e thu votoni sipas qejfit të juaj, e keni të drejtën, e kem të drejtën e votës me votu.

Ne kena kërkuar një raport edhe për pronat e mandatit të kalum, Unë nuk e di pse duhet me u mbështetë, zonja, në lista e pronave, me shtatëdhjetë prona pse duhet me u mbështetë lisa e pronave me shtatëdhjetë pronat, kur në njëfarë mënyre na për pronat e mandatit të kalum, hale s'kemi raport, pronat janë duke i shfrytëzuar njerëzit, dhe besoj që afatet ligjore dhe janë përmbyllë, por nuk na ardhë asnjë raport.

Votimi jem është kundër, i nderum kryesuese mos e shtyej edhe një muaj, se e njëjta është përgjigjja edhe mbas një muaji, se u dashtë me kanë ma serioz, prona është diçka e shenjtë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Unë e kam obligim ligjor me sjellë për miratim në listën paraprake. Është vendimi juaj që me vendos, a i kam votat, a s'i kam votat, pak rëndësi ka. Fole për pronat e dhomës, për çdo pronë unë kam raportu dy herë në vjet. veç duhet me i lexu raportet.

Ato prona që i kemi dhënë 2020 bashkë, që u kanë edhe vit i pandemisë, krejt janë funksionale krejt e paguajnë edhe qiranë edhe kanë bërë investimin shumëfish më të madh se që e kanë qitë në thirrje.

Egzona Tërdevci: në emër të Grupit të Këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, ne propozojmë që pika të mbetet në shqyrtim, pika ka ardhë me kohë, i kemi materialet, nuk kem arsye për me shty ose me heq këtë pikë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Unë e kam tërheq pikën prej rendit të ditës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari, theksoi se me kërkesën e kryetarit të komunës u tërhoq nga rendi i ditës pika: **Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 872-2 në Kishnarekë.**

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 21 anëtar, “Për” votuan 21 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit në zonën kadastrale Kishnarekë.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Ministria, përkatësisht Enti na ka kërku disa herë një pronë prej një ari edhe na e kemi diskutu me ta disa herë e kanë identifikuar një zonë mbi shkollë të Kisharekës, një ari edhe na ia kena propozu Kuvendit që me ia dhënë atë mundësi entit sizmik.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim Vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 202-0 Shtrubullojë.**

Labintot Halilaj: Debatet dhe sqarimet është mirë me i ba edhe për qytetarin, ne mundemi pas materialet, por është mirë me ba dhe sqarime për qytetarin.

Po flasim te pjesa e pika e shtatë Propozim-vendimin për dhënë në shfrytëzim afat gjatë. Na e votuam, do me thënë, në ndarjen e parcelës dy shtatë dy dhe a është e njëjta që kjo tash për shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetë e nëntëdhjetë?

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU’Rasim Kiqina’ në Shtrubullojë.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci : Të gjithë asambleistët e dinë që na e kemi kërku kur e kemi miratu buxhetin një kod buxhetor për ndërtimin e shkollës në Shtrubullojë, shkollës pjesë e “Rasim Kiqinës” sepse na nuk muajna me nis procedurë për shkollë të re me emër të ri, po edhe që kemi thënë ta ndajmë parcelën, e kemi bërë kodin kur është miratuar buxheti.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 22 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Raporti i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2023.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: e kemi obligim ligjor për me raportu para kuvendit dy here në vit. Ky raport nuk votohet vetëm debatohet.

Nuk pati për diskutim rreth kësaj pike të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Raporti i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Drenasit për vitin 2023 dhe plani i implementimit të rekomandimeve.**

Kamer Rama-Auditor i brendshëm: Për të përmbushur një kërkesë në pyetësorin e vlerësimit të performancës ne kemi përgatitur një raport përmbledhës vjetor të auditimit të brendshëm, njesisë së auditimit të brendshëm për 2023, në këtë raport janë të evidentuar aktivitetet themelore të njesisë së auditimit të brendshëm, duke filluar nga hartimi i planit strategjik, hartimi i planit vjetor, auditimet e planifikuara dhe të përfunduara. Raportimet para Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë Financave, përkujdesjen e vazhdueshëm gjatë vitit 2023 për implementimin e rekomandimeve të dhëna si dhe raportimin e shkallës së implementimit tyre. Në këtë raport është pasurua edhe puna e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe ku gjithsej brenda vitit 2023 i ka mbajtur katër mbledhje të rregullta.

Gjatë vitit dy mijë e njëzet e tre janë kry gjithsej shtatë auditimet fushat e caktuara të cilat janë të listuar në raport.

Nga këto auditime janë dhënë gjithsej pesëdhjetë rekomandime, prej të cilave njëzet e pesë rekomandime apo pesëdhjetë për qind e tyre janë të implementuara tërësisht shtatëmbëdhjetë ose tridhjetë e katër për qind janë pjesërisht të implementuara dhe tetë apo 60% janë të pa implementuara ende.

Rekomandimet të cilat janë të paimplementuara i takojnë raportit të fundit të auditimit, i cili ju ka dërgu menaxhmentit me njëzet e nëntë dymbëdhjetë dy mijë e njëzet e tre, pra ka qenë fundi i vitit dhe nuk ka pas një periudhë krahasuese për me verifiku shkallën e implementimit të tyre.

Të gjitha rekomandimet e dhëna gjatë vitit, paraprakisht janë dakorduar me menaxhmentin.

Pas çdo raporti ne i marrim komentet nga menaxhmenti, dhe duke i inkorporuar këto komente e bëjmë konsolidojmë raportin final të auditimit, ndërsa pas çdo konsolidimit të raportit final të auditimit, brenda një afati të caktuar prej pesëmbëdhjetë ditëve ne i marrim ë planin e implementimit nga menaxhmenti.

Gjatë vitit 2023 kemi vërejtur se menaxhmenti i ka zhvillu gjithsej pesëdhjetë e tetë aktivitete që kanë të bëjnë me implementimin e rekomandimeve, përmes tyre pesëdhjetë e tetë aktiviteteve ka arritur me i implementu në tërësi njëzet e pesë rekomandime dhe pjesërisht shtatëmbëdhjetë. Ne e falënderojmë me na më menaxhmentin e komunës për aktivitetet që i kanë zhvillu për implementimin e rekomandimeve gjithashtu Inkurajojmë menaxherët tjerë, të cilët ende nuk kanë mund që të implementojnë qind për qind rekomandimet tona. që të vazhdojnë me aktivitetet e tyre për implementimin e rekomandimeve.

Egzona Tërdevci: faleminderit shumë z.Ramaj për prezantimin vlen ajo që e kam thënë edhe tek rendi i ditës, e kuptoj që mund të jetë kufizim ligjor, megjithatë ne nuk mund të trajtojmë një raport ose të diskutojmë për të, pa e ditur çka trajton përmbajtjesisht. Megjithatë, meqë keni ardh këtu dhe keni prezantuar, faleminderit shumë për mundin!

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës: **12. Raporti i performancës komunale për vitin 2022.**

Afrim Prokshi-Zyrtar komunal- koordinator për performancën komunale: para jush paraqes raportin e performancës komunale 2022, i cili është i shpallur për vitin 2023.

I keni pa dot rezultatet, ku komuna vlerësohet për njëqind e nëntëmbëdhjetë tregues, përkatësisht për nëntëmbëdhjetë fusha dhe nga këto rezultate del që Komuna jonë është një ndër komunat e para që vlerësohet për performancë të mirë komunale dhe njëkohësisht edhe për grantin e performancës komunale jemi ndër komunat e para që vlerësohemi maksimum pothuajse pikë, mirëpo për grant këtë vit, ndoshta nuk do të mund të klasifikohem për shkak të disa çështjeve të tjera, që nuk është temë e diskutimit.

Kështu që, në këtë rast dua ta falënderoj edhe Kuvendin, sepse shuma e tre diku njëmbëdhjetë pikë që kërkohen në grantin e performancës komunale, janë meritë e juaja, vendimet që merrni këtu, vendimet për buxhet, të gjitha ato janë meritë e Kuvendit mirëpo nuk do të harruar edhe punën dhe përkushtimin e kryetarit të komunës, bashkë me drejtorët e drejtorive dhe të gjithë zyrtarëve të tjerë të cilat të gjithë së bashku do të kanë arritë që puna jonë të jetë lidere në performancë Komunale.

Andaj, nuk pe zgjati më shumë, në qoftë se keni ndonjë pyetje, diçka apo për ndonjë tregues apo për diçka tjetër, mirëpo na mendojmë që komuneve do të vazhdojë edhe për këtë vit të jetë komunë lidere në performancën e komunave, për faktin për punën e përgjithshme, të përbashkët që jemi tu u ba edhe si ekzekutiv, mirëpo edhe njëkohësisht edhe juve si kuvend i Komunës së Drenasit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: por i falënderoj edhe të gjithë anëtarët e Komisionit, që t'i mbledhin gjitha dhënat e i fus në sistem për punën që e kanë ba, e kam thanë edhe me dhjetëra herë falënderohemi edhe Kuvendin për vendimet ku janë kanë të rëndësishme me i marrë, po shpeshherë ka pas edhe ku e kanë dëmtu procesin me mos marrje të vendimeve ose me zvarritje të marrjes së vendimeve.

Na jemi vendin e parë edhe ashtu e kemi bashkë me Rahovecin, por nuk jena përfitues të grantit si rezultat i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimiti cili na ka nxjerrë keqklasifikim pasqyrave financiare.

Për dijenitë juaj, keqklasifikim të pasqyrave financiare në shumën e nevojshme për keq klasifikim nuk kena pas dhe nuk kena.

Keqklasifikim na kanë konsideru kontratat kolektive të arsimit dhe të shëndetësisë, të cilat i kanë lidhë ministrinë e linjave pa zotimin ose miratimin e buxhetit paraprak për ato kontrata dhe na jena penalizu, sepse gjithë punonjësit e arsimit të shëndetësisë, na kanë paditë edhe si rezultat i padive jena dëmtu miliona euro si komunë edhe na kanë dalë pasqyrat keqklasifikim Unë i kam marrë të gjitha veprimet si zyrtar kryesor, administrativ ose si kryetar.

E kam paditë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shëndetësisë, sepse me fajin e tyre dhe pa fajin e tonë Komuna e Drenasit i ka humbë miliona euro dhe kësaj padie do t'ia shtojmë edhe shumën në këtë granti që po e humbëm si rezultat i veprimeve të Qeverisë karshi komunës.

Kështu që qytetarëve Komunës së Drenasit jam mirënjohës, kryetarëve të lokaliteteve, zyrtarëve të komunës në përgjithësi, po edhe juve si asamblistë për sukseset që vazhdon me i pas Komuna e Drenasit me qenë kampione e qeverisjes të mirë.

Egzona Tërdevci: pikërisht këtë pjesën që e sqaroi zotëri Lladrovci, kisha dashtë me e ditë edhe bazën e argumentimit të kësaj, se ne e kemi humb grantin e performancës për shkak që ka një raport të kundërt të auditimit.

Sa e di unë, ky është veç një prej treguesve, gjithëherë po kërkoj sqarime, sepse nuk jam e

thirrur me e ditë ma së miri këtë plan performancës, vërehet se ne kemi pikë pak edhe në tregues të tjerë, nuk është vetëm çështja e raportit të auditimit.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, kurrë nuk mund me i plotësu të gjithë treguesit. ketë qe e ceke komitet joshumicë, ne në komunë nuk jemi serb, që s'guxoj me thanë fatmirësisht, nuk kemi komunitete tjera, roman, rom, e tjera e tjera dhe na të gjithë i humbëm këto pikë, gjithmonë një komunë tjetër na del tri pikë përpara, veçse ka komunitete tjetër jo shqiptar në komunën e saj.

Tregues pse kena ra prej grantit të performancës, veç grantin nuk e marrim, ne jemi parët. Është se janë tre tregues, tregues të cilët duhet me i pas patjetër raportin e auditimit kualifikim të mirë, që na kemi keqklasifikim, mbledhjet e kryetarit që merr pjesë në seanca edhe edhe buxhetin shtatëdhjetë e pesë për qind të investimeve kapital. Këto trija, nëse njëren prej këtyre trijave nuk e arrijmë nuk e fitojmë grindin e performancës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës: **13. Raporti i komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës të dhëna në shfrytëzim gjatë vitit 2020.**

Labinot Halilaj: Kërkoj me ardhë një raport ë prej krejt pronat që janë dhënë në mandatin e kaluar.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Raporti për pronat që i kena dhanë është një raport që e bën një komision i veçantë dy herë në muajt e ka kërkuar Florentina me bë të veçantë, e këna bo të veçantë. Raporti flet prona u dhanë me çdo kriter.

A janë plotësu qato kriteret, a nuk janë plotësu?

Pra, një pronë që e ke na dhanë a e ka përmbush numrin e punëtorëve?

A e ka përmbush investimin? A e ka përmbush pagesën, dhe është raporti që bohet, edhe atë e keni.

Pronat qe i kemi dhënë, krejt e kanë përmbushë këtë kriter krejt e paguajnë qiranë edhe krejt janë në rregull, përveç që u kanë kjo në Komoran për shkak të problemeve që e dimë që i kena pas ju Ministria, edhe gjithçka është në rregull.

Pronat tjera kanë probleme dhe na jena të obligun ai që s'e pagun Qiranë me qu të përmbaruesi, unë jam marrë njëanshëm çdo kompanie që nuk i kryejnë obligimet e kontratës.

Egzona Tërdevci: një nga kriteret në shpalljen e datës 16.09.2020, të publikuar në faqen e Komunës së Drenasit është edhe fakti se afati i realizimit të projektit të investimit për secilin biznes është tetëmbëdhjetë muaj.

Duke u nisur nga ky kriter, po edhe elemente tjera po ndalemi tani tek secili biznes veç e veç, meqë janë të përmendur në raport, po i përmend edhe unë me emra, ashtu siç ju jeni siç janë të identifikuar në raport.

Biznesi i IP-KOS në Drenas kishte aplikuar me planin për pompë derivate, por edhe sipas raportit nga ju aty ushtrojnë veprimtari edhe biznese tjera, meqë nuk është në rregull kjo a i është dhënë vërejtje biznesit, a është realizuar investimi nga kjo kompani dhe numri i punëtorëve. Tek prona e Ferr Petrol në Gllobar biznesi kishte aplikuar me idenë për qendrën edukative në komunikacion, sipas raportit po edhe nga terreni vërejmë, aty ka një pompë të derivateve jo një gjë të tillë, pra ajo për çka ka aplikuar biznesi, gjithashtu, edhe për këtë

biznese është realizu investimi sipas idesë fillestare dhe a është realizu numri i punëtorëve. Është një shqetësim tjetër tek biznesi, tek Ragip Veseli, edhe sipas aplikimit fillestar aty është aplikuar për pompë derivate, po pikërisht sipas raportit që na është dorëzuar, aty ka edhe biznese tjera madje përmendët që janë edhe dy pronare, që nuk është pjesë e aplikimit a është marrë ndonjë masë nga Komuna në raport me këtë pronë po ashtu edhe për këtë biznes vlen e njëjta se a është realizu investimi i milionësh që është prezantuar dhe a është realizu punësimi i punëtorëve në bazë të programit.

Biznesi Elkos a e ka realizu edhe ky ka një investim mijëra euro, a është investu ky realizim ky investim siç është përmend në fillim dhe janë punësuar punëtorët që janë çekur në aplikim. Çka duhet çekur për të gjitha këto biznese është që vlera e qerasë është jashtëzakonisht e ulët, e sidomos nëse kemi parasysh faktin që bizneset që kanë marrë pronë në shfrytëzim, atë pronë pastaj e kanë lëshuar për personat e tretë, e nuk do mend që kështu edhe përfitimi i tyre është më i madh.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Biznesi i IP-KOS në Drenas e ka përmbush kontratën plotësisht, krejt çka i ka aty, i ka edhe në deklaratë, pra, pompë benzine me objektet përcjellëse krejt qatë, i ka edhe me fotografi, me incizime.

Sigurisht, kur ka ndonjë kërkesë për ndryshim të projektit, na ia lejojmë ndryshimin e projektit, po investimi është dyfish, nëse jo më shumë, numri i punëtorëve është më i madh se që e ka të paraparë, edhe tatim qiranë e paguan shumë shtrenjtë. Prona, në Arllat, ku Asamblistja jote, e ka pas autoshkollë, e ka marrë prej autoshkollë dhe a ke pyet ndonjë herë sa e ka pas qiranë në vit gjë që nuk e ka zhvillu projektin.

Fer Petrolli i ka plotësuar të gjitha kriteret edhe është konform çdo kriteri që e ka pas. Te Ragip Veseli e thashë edhe paraprakisht një pronë, ia kena marrë dikujt që s'e ka zhvillu procedurat. Edhe ajo El-Kos në Komoran, ajo e ka kry krejt bile shumë shpejt, e ka bërë investimin, e ka bërë punësimin, i ka bërë krejt.

Egzona Tërdevci: Unë çka mora përgjigje prej juve lidhur me këto prona është se secila e ka investu dhe e ka realizu investimin ashtu siç e ka planifikuar.

Për këtë arsye, edhe për shkak se në aplikim, realisht kanë aplikuar me ide të tjera, unë kam kërku qasje në dokumente publike me pa edhe aplikimin e secilës kompani prej tyre, po edhe me pa ndoshta edhe numrin e punëtorëve ai ka analizu përnime atë numër të punëtorëve.

Unë nuk jam ekspert as inspektore tatimore, po me sy të lirë vërehet që nuk janë të punësuar tanë ata punëtorë që janë paraqitur në raport.

E sa i përket pronave që i kemi kërkuar përmes zonjës së Elezi, ka qenë edhe për pronat që keni mujt me i dhanë ju, ato që ju lejohet me i dhanë ju në vitin 2021 edhe ato i kemi kërku me pas në raport, po veç ju keni sjellë në rregull.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: për që s'i kanë realizu projektet, për që nuk e kanë numrin e plotësuar të atyre që kanë fitu prona prej Komunës së Drenasit është veç parku i biznesit.

Janë edhe këto pronat e madh ma të mëhershme, ku e keni raportin që sa punetore i kanë gjendje edhe sa duhet mi pas.

Ne i kemi dhënë vërejtje për këto, për çdo kanë që nuk e ka plotësuar numrin e punëtorëve.

Pra, në park të biznesit e ka obligim qeveria me mbledhë qiranë, e me ia dhënë komunës, e po duhet me ia marrë në me përmbarues, edhe ka gjysmë milioni euro edhe ka obligim me i

përcjellë e me i kontrollu numrin e punëtorëve e investimeve të parkut të biznesit.

Filloreta Bujupi: kërkoj që më mos t'i përmendet me emri i bashkëshortit dhe familjes të saj në Kuvend.

